



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Kryetarit

Datë: 20-09-2021

01 Nr. Protokoll: 11-33187 /2021

Referencë: Konkursi Nr. 02/112-30620/2021-Ekspert i Jashtëm

NJOFTIM PËR VAZHDIM AFATI PËR APLIKIM

Konkursi-shpallja publike për angazhim të një eksperti të jashtëm për procedurat e rekrutimit në pranim, i shpallur me datën 06-09-2021 VAZHDOHET për këto arsye:

- Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë kërkon që eksperti i jashtëm të jetë nga ndonjë organizatë e specializuar që merret me rekrutim të burimeve njerëzore si dhe profesorët universitar të fushës përkatëse (p.sh. nëse grupi i pozitave që rekrutohet është jurist , profesori duhet të jetë nga fakultetet juridike).
- Po ashtu, edhe Rregullorja 16/2020 e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes nenit 18, pika 2.3 përcakton të njëjtin kriter përzgjedhës për ekspertin e jashtëm si anëtar i komisionit për pranim.

Në konkursin në fjalë, asnjë nga kandidatët që aplikuan në afatin fillestar nuk i plotëson kriteret e cekura më lartë dhe prandaj ky konkurs vazhdohet deri me datën 23/09/2021.

Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës

